



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.
Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 17.
Prishtinë, më 30.03.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fitore Pacolli dhe Fatmire Kollçaku .

Munguan: Adem Hoxha. dhe Glauk Konjufca.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ-i, OSBE-ja, NDI-ja, KDI-ja, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu Kodra, kryetare e Komisionit

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Të ndryshme.

Kryetarja Blerta Deliu-Kodra, tha se bazuar në vendimin e seancës plenare të datës 23 mars, jemi dakorduar që të përshpejtojmë shqyrtimin e projektligjeve që janë në raportin e Progresit, që do të publikohet në muajin prill.

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Në lidhje me këtë Projektligj, **kryetarja** paraqiti opinionin ligjor.

Ky Projektligj përmban gjithsej 26 nene dhe 37 amendamente të Komisionit Funkcional.

Projektligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, pas shqyrtimit është konstatuar se ky Projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, konstatoi se ky Projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

Në lidhje me këtë Projektligj, **kryetarja** paraqiti opinionin ligjor.

Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, pas shqyrtimit është konstatuar se ky Projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me amendamentet e propozuara nga Komisioni, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Në lidhje me këtë Projektligj, **kryetarja** paraqiti opinionin ligjor.

Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, u konstatua se dispozitat e këtij Projektligji së bashku me amendamentet nuk janë në kundërshtim me

legjislacionin e BE-së dhe nuk cenojnë parimet e përgjithshme bazë të *Acquis* të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend. Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe nuk cenojnë parimet e përgjithshme bazë të *Acquis* të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Të ndryshme.

Ne këtë pikë nuk pati diskutime.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Blerta Deliu-Kodra